



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233420
Datë: 27.12.2023
Numri i dokumentit: 05129974

C-IV.-14-5352

Ankuesi:

F B, Shtime

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “Shtime”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, 27 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 11 korrik 2014, parashtruesi ka dorëzuar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, kundër vendimit nr. PRN-020-0053 të nxjerrë nga Autoriteti i Likuidimit të AKP-së më 12 qershor 2014.

Parashtruesi deklaroi se kërkesën për rishikim të vendimit e dorëzon përshkak të :

- Vërtetimit të gabuar dhe jotë plotë të gjendjes faktike dhe,
- Shkeljes së të drejtës materiale

Po ashtu, parashtruesi theksoi se KB “Shtime” nuk i ka kryer obligimet pas procesit të privatizimit si dhe gjatë procesit të privatizimit, pasi nuk ka mbuluar asnjë lloj shpenzimi për periudhën e lartë përmendur, përkundër periudhës që është angazhuar vazhdimisht.

Kësisoj, parashtruesi ka kërkuar nga gjykata rishikimin e vendimit të AKP-së nr. PRN-020-0053 i datës 12 qershor 2014, ashtu që e paditura të paguajë shumën prej 1.050.00 (3 x 350 euro) në emër të pagave të papaguara, apo të njëjtin vendim ta prish dhe çështjen ta kthejë në rivendosje Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi për gjykatën ka prezantuar: *Kopjen e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. PRN020-0053, të datës 12 qershor 2014;*

AKP-ja, kërkesën për kompensim për tre paga të papaguara e refuzoi duke iu referuar nenit 40.1.6.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh që: *tre pagat e papaguara të punonjësve janë kërkesa prioritare, dhe si të tilla kanë prioritet më të lartë. Megjithatë, ky nen nuk i njuh të gjithë punonjësve automatikisht të drejtën për tre paga, por i jep prioritet tre pagave të fundit që mund të kenë mbetur të papaguara, nga totali i pagave që ndërmarrja nuk i ka paguar punonjësve. Në çdo rast, kërkesa për paga të papaguara, duhet të mbështetet me prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes. Ky nen në vetvete nuk i njuh automatikisht të drejtën ndonjë punonjës për kompensim me tre paga.*

Poashtu, AKP-ja kërkesën e refuzoi si të pavlefshme duke u bazuar në Nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në i cili parasheh që: “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:...kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;”

Më 22 dhjetor 2023, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 26 qershor 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN-020-0053 i datës 12 qershor 2014.

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të PRN-020-0053 i datës 12 qershor 2014.

Më 5 dhjetor 2023, Zyrtarja për Financa i ka dërguar parashtruesit të ankesës vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i cili ka hyrë në fuqi më 01 maj 2017, ose të paraqesë prova që bën pjesë në kategorinë e palëve për t’u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore. Parashtruesit të ankesës iu bë me dije lidhur me pasojat juridike nëse në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga data e pranimit të kësaj vërejtjeje nuk e paguan taksën gjyqësore.

Për më tepër, parashtruesi i ankesës është obliguar që ta paguaj taksën gjyqësore për ankesën e parashtruar konform nenit 253.4 të LPK-së. Ankuesi ka pasur mundësi të parashtronte kërkesë për lirim nga taksat gjyqësore. Në bazë të fletkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës, gjykata vëren se më 6 dhjetor 2023, paditësi e ka pranuar urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore por gjer më sot të njëjtën nuk e ka paguar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Sipas nenit 76 par.3 i Ligjit Nr.06-L-086, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Paditësi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh: “Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas urdhrit të dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Ankuesit i është lejuar afati prej pesëmbëdhjetë ditëve që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor. Ankuesi ka për obligim të paguaj taksat gjyqësore.

Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Parashtruesi i ankesës më 6 dhjetor 2023, e ka pranuar urdhrin e gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore por gjer më sot nuk e ka paguar dhe rrjedhimisht nuk ka dorëzuar në gjykatë dëshmi për pagesën në fjalë.

Nga e gjithë kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore:

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja
Manushe Karaqi